

E drejta për informim

Newsletter mujor mbi mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për të Drejtën e Informimit

Newsletter është publikim i Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale

Fokusi i muajit

Marrëdhëniet me Kuvendin

Bazuar në ligjin nr. 9887/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar dhe veçanërisht në ligjin nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit" përcaktohen marrëdhëniet e Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale me Kuvendin e Republikës së Shqipërisë.

Komisioneri raporton në Kuvend ose në komisionet parlamentare të paktën një herë në vit ose sa herë që kërkohet prej tyre. Gjithashtu, ai mund t'i kërkojë Kuvendit të dëgjohet për çështje që i çmon të rëndësishme. Raporti përmban të dhëna dhe shpjegime për zbatimin e së drejtës për informim në Republikën e Shqipërisë, si dhe programet e transparencës.

Gjatë përpilimit të raportit, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale mbledh të dhëna nga autoritetet publike dhe nga organizatat jofitimprurëse që kanë për mision mbrojtjen e lirive dhe të drejtave themelore të njeriut, duke evidentuar komunikimet përkatëse.

Pas raportimit vjetor, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë shqyrton veprimtarinë e Zyrës së Komisionerit dhe bën konstatimet e tij duke miratuar rezolutën për vlerësimin e veprimtarisë për vitin raportues. Kuvendi i Republikës së Shqipërisë i kërkon Zyrës së Komisionerit, në përmbushje të detyrimeve të parashikuara në ligj, të përcaktojë drejtimit kryesore në të cilat duhet të fokusohet aktiviteti në vitin pasardhës.

Përmbledhje mujore e vendimeve dhe rekomandimeve

Vendim nr. 53 - Bashkia Kurbin

Vendim nr. 54 - Komisioni i Pavarur i Kualifikimit

Vendim nr. 55 - Bashkia Krujë

Vendim nr. 60- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë

Vendim nr. 61 - Drejtoria e Përgjithshme e Doganave

Vendim nr. 62 - Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Vendimmarrja e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale

TRANSPARENCA E AUTORITETEVE PUBLIKE ËSHTË NJË NGA SHTYLLAT E MIRËQEVERISJES

VIZITONI WWW.IDP.AL

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, gjatë muajit dhjetor 2021, ka dhënë 6 vendime urdhërimi në zbatim të ligjit 119/2014 "Për të drejtën e informimit".

Me anë të vendimit nr. 54, datë 07.12.2021, Zyra e Komisionerit ka vendosur pranimin e ankesës ndaj "Komisionit të Pavarur të Kualifikimit" (Autoriteti Publik), me objekt "Ankim ndaj refuzimit për dhënie të informacionit dhe kopje të dokumenteve zyrtare", ku kërkohej informacion mbi:

Emrin dhe kopjen e kontratës së nënshkruar me kompaninë/sipërmarrjen private që ka kryer mbështetje financiare të Autoritetit Publik, për të përballuar koston financiare të shpenzuar në kuadër të aktivitetit me temë "Raport & Strategji", të zhvilluar më datë 30 shtator 2021, në ambientet e hotel "Marina Bay", Vlorë.

Autoriteti publik pasi kishte shqyrtuar kërkesën informoi kërkuuesin se "Një pjesë e informacioneve të diskutuara në aktivitet janë konfidenciale, po ashtu organizimi dhe zhvillimi i këtij aktiviteti përmban klauzola kontraktuale, që e kufizojnë aksesin e palëve të treta jashtë këtij aktiviteti".

Kërkuuesi i informacionit me pretendimin se është cënuar në të drejtën për informim, ka paraqitur ankim pranë Zyrës së Komisionerit duke i kërkuar ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit.

Zyra e Komisionerit, pas shqyrtimit paraprak të ankesës, bazës ligjore dhe rrethanave të faktit të paraqitura në të, vlerësoi se ankesa përmbush kriteret formale ligjore, në përputhje me përcaktimet e nenit 24 të ligjit nr. 119/2014, "Për të drejtën e informimit", (në vijim LDI).

Pas ndërhyrjes së Zyrës së Komisionerit, Autoriteti Publik në përgjigjen e tij argumentoi se "...Marrëveshja tri-palëshe ndërmjet kompanisë financuese dhe ofruesit të shërbimit që ka kryer organizimin për llogari të eventit të Autoritetit Publik, parashikon klauzola kufizuese dhe përjashtuese për palët e treta jashtë kësaj marrëveshje sponsorizimi. Duke qenë se marrëveshja ka natyrë konfidenciale, si dhe duke mbajtur parasysh nenin 17 të ligjit nr. 119/2014, Komisioni ka vlerësuar objektivisht dhe proporcionalisht që nga njëra anë kërkuuesi të

#informim #transparencë #vendim

informohet dhe nga ana tjetër të mos çënohet e drejta private e palëve në këtë marrëveshje sponsorizimi, duke mos i vënë në dispozicion detaje për palën financuese.

Autoriteti Publik i ka konsideruar shteruese dy përgjigjet që i ka kthyer kërkuuesit, duke e informuar atë mbi: temën e aktivitetit, kohëzgjatjen e tij, vendin ku është organizuar, numrin e pjesëmarrësve, akomodimin e komisionerëve dhe stafit ndihmës, si dhe koston totale të shpënzimeve të kryera dhe të mbuluara nga marrëveshja tri-palëshe për këtë aktivitet

Nga shqyrtimi i çështjes, Komisioneri konstatoi se Autoriteti Publik nuk provoi në asnjë moment, se në cilën pikë të nenit 17 të LDI e mbështet qëndrimin e tij lidhur me mosvënien në dispozicion të dokumentacionit të kërkuar, apo kufizimin e pjesëve të anonimizuara të kësaj marrëveshje. Për rrjedhojë, në mungesë të një dispozite të posaçme ligjore për të legjitimuar diskrecionin e Autoritetit Publik, për të kufizuar të drejtën për informim të publikut, nëpërmjet parashikimeve të klauzolave kufizuese dhe përjashtuese, të përcaktuar në këtë marrëveshje, Komisioneri e gjen qëndrimin e mbajtur nga Autoriteti Publik në kundërshtim me LDI.

Autoriteti Publik, në kundërshtim me LDI, ka anonimizuar edhe të dhënat e shoqërive tregtare të cilat nuk konsiderohen si të dhëna personale dhe përpunimi i të dhënave të tyre nuk kufizohet nga ligji nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar. Në këto kushte, nga Autoriteti Publik duhet të rivlerësohet dokumentacioni dhe vetëm nëse marrëveshja përmban të dhëna personale të subjekteve të të dhënave, të cilët nuk janë përfaqësues të shoqërive tregtare, përhapja e të cilave mund të çënojë privatësinë, në këtë rast, këto të dhëna duhet të anonimizohen.

Në përfundim të procesit administrativ të shqyrtimit të ankesës, KDIMDP vendosi urdhërimin e Autoritetit Publik për dhënie të informacionit të kërkuar, duke respektuar kufizimet, në përputhje me pikën 6 të nenit 17 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit".

Për më shumë informacion mund të lexoni të plotë vendimet në faqen e KDIMDP www.idp.al


Bashkëpunim me Institucionet e Arsimit të Lartë për ndërgjegjësimin e studentëve

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ka bashkëpunuar me Institucione publike të Arsimit të Lartë (IAL) apo organizata studentore për rritjen e ndërgjegjësimit për ushtrimin në praktikë të të drejtave të qytetarëve.

Gjatë muajit dhjetor 2021 u zhvilluan trajnime/takime në fokus të të cilave ishte njohja me legjislacionin e zbatueshëm në të dy fushat e kompetencës së institucionit. Në to morën pjesë kryesisht studentë, por edhe staf akademik e administrativ nga Universitetet “Luigj Gurakuqi” të Shkodrës, “Aleksandër Moisiu” të Durrësit, “Fan Noli” të Korçës dhe anëtarë të Klubit Studentor nga Fakulteti i Drejtësisë së Universitetit të Tiranës.

Të pranishmit në këto aktivitete u njohën me rolin, funksionet dhe veprimtarinë e Zyrës së Komisionerit për mbikëqyrjen e zbatimit të kuadrit rregullator, si dhe u trajtuan një sërë rastesh nga praktika.

Gjithashtu, në këto takime vëmendje iu kushtua aspekteve të ndryshme për forcimin e transparencës proaktive të Autoriteteve Publike dhe rritjes së përgjegjshmërisë në përpunimin e të dhënave personale nga kontrollues publik e privat.



E drejta e aksesit në informacion dhe përdorimi i saj nga grupet vulnerabël

Në kuadër të Sesionit të Hapur të Konferencës Ndërkombëtare të Komisionerëve të Informimit (ICIC) 2021, u zhvillua online në datën 10 dhjetor 2021 seminari “E drejta e aksesit në informacion dhe përdorimi i saj nga grupet vulnerabël”.

Ky aktivitet u ndoq me mjaft interes nga përfaqësues të Zyrës së Komisionerit duke marrë në konsideratë rëndësinë e tij ku u trajtuan tema në lidhje me problematikat në kuadër të ushtrimit të së drejtës së aksesit në informacion për grupet vulnerabël, të tillë si personat me aftësi të kufizuara apo grupe të tjera që janë objekt i diskriminimit.



Brasilia Brazil

THE DATE

10 / 12

2PM UTC

Workshop Transparency, gender and groups in situation of vulnerability

Today more than 120 countries have enacted right to information (RTI) laws and the countries respective oversight bodies have played a key role in their implementation– including making this right more visible for the communities. Despite of all efforts, a significant percentage of the population is still unaware of this right, particularly those in most vulnerable situation.

Në këtë takim referuan ekspertë nga autoriteti Brazilian i Informimit, të cilët janë edhe organizatorë e të gjithë aktivitetëve që janë zhvilluar gjatë vitit 2021 në kuadër të Konferencës së vitit 2021.

Gjithashtu, kontribues të tjerë ishin delegatë nga autoriteti Meksikan, Indian, Afrikës së Jugut, etj., të cilët ndanë eksperiencat e tyre lidhur me iniciativat apo problematikat në vendet përkatëse.

Përgjithësisht, nuk janë ndërmarrë masa dhe ka pasur përpjekje minimale për t'i garantuar aksesin në informacion grupeve vulnerabël. Pjesëmarrësit mbështetën idenë e hartimit të një dokumenti politikash i cili do të vendosë standarde për garantimin e të drejtës për informim të këtyre grupeve individësh.

Pjesëmarrësit theksuan nevojën për rritje të bashkëpunimit dhe koordinimit me shoqërinë civile apo grupe të tjera interesi për të bërë më shumë përpjekje në kuadër të garantimit të së drejtës për informim dhe transparencës ndaj personave me aftësi të kufizuara.